REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI SHTETËROR PËR INFORMACIONIN GJEOHAPËSINOR**
**DREJTORI I PËRGJITHSHËM**
**KOMISIONI I EKSPERTIZËS**

Nr. 593/3 Prot.

Tiranë, më 14.01.2026

Lënda: **Lista konkrete me afatet e ruajtjes së dokumenteve të Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor - ASIG**

Bazuar në nenin 7, pika 1, të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, "Për arkivat", i ndryshuar, nenet 32 dhe 33 të "Normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë", nenit 6 të Vendimit nr. 4, datë 19.06.2017, Për miratimin e "Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar si dhe urdhrit nr. 07, datë 07.01.2026, "Për ngritjen e Komisionit të Ekspertizës", Komisioni i Ekspertizës i ASIG, në mbledhjen e datës 14.01.2026 shqyrtoi dhe miratoi listën me afatet e ruajtjes së dokumenteve.

**Miratoi:**

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM**
**Vilma Tomço**

| Nr. | Lista e dokumenteve që administrohen nga protokolli/arkiva | Afati i ruajtjes |
|---|---|---|
| | **I. Drejtori i Përgjithshëm** | |
| 1 | **Dokumente për organizimin, funksionimin dhe veprimtarinë e ASIG** | |
| A | Vendime, urdhra, udhëzime, rregullore, programe, plane pune, delegime, raportime, për organizimin, funksionimin dhe veprimtarinë e Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor, etj. Marrëveshje me institucione të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, me donatorë të ndryshëm, etj. | RHK |
| A | Dokumente të ndryshme, kontrata, korrespondenca me institucione të ndryshme, në lidhje me projektin "Shërbimi Satelitor", etj. | RHK |
| B | Relacione, informacione periodike përmbledhëse mbi veprimtarinë e institucionit, memo, procesverbale, etj. Kërkesa/memo për lëvizje jashtë vendit, | 25 vjet |

| | | |
|---|---|---|
| | etj. Referenca/rekomandime, letër mbështetëse. Korrespondenca të thjeshta, etj. Autorizime të ndryshme si p.sh: për punonjësit, etj. | |
| | **II. Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm** | |
| **2** | **Dokumente për organizimin, funksionimin dhe veprimtarinë e ASIG** | |
| **A** | Vendime, urdhra, udhëzime, marrëveshje, rregullore, programe, plane pune, delegime, raportime për organizimin, funksionimin dhe veprimtarinë e Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor, etj. | RHK |
| **B** | Relacione, informacione periodike përmbledhëse, memo, procesverbale. Referenca/rekomandime, letër mbështetëse. Materiale ndihmëse, korrespondencë e thjeshtë etj. | 25 vjet |
| | **III. Drejtoria e Gjeodezisë dhe Hartografisë** | |
| **3** | **Dokumente, shkresa në veprimtarinë e Drejtorisë së Gjeodezisë dhe Hartografisë** | |
| **A** | Urdhra, vendime, udhëzime, raporte, rregullore, programe pune, marrëveshje, procesverbale mbi veprimtarinë e drejtorisë. Kontrata me institucione/ organizata jashtë vendit. Projekte të ndryshme dhe CD me matjet në terren (CD me produktet hartografike të përftuara), etj. | RHK |
| **B** | Memo nga sektorët përkatës të drejtorisë, materiale, informacione shkresore dhe me CD lidhur me punën e punonjësve në terren lidhur me përftimin e produkteve hartografike në zona të ndryshme të Shqipërisë referuar planit të punës. Projekte, specifikime teknike në fushën e Gjeodezisë dhe Hartografisë. Programe/plane pune, urdhra, autorizime, raporte, korrespondencë, memo për dorëzim materiali, lidhur me shërbimet në terren të grupeve të punës, etj. Realizimi i matjeve GNSS të pikave të rrjeteve gjeodezike të Republikës së Shqipërisë, monitorimi dhe verifikimi i funksionimit të stacioneve të rrjetit gjeodezik aktiv ALBCORS, të rrjeteve aktive të KRGJ-së. Kontrolli fizik, verifikimi i gjendjes së pajisjeve të stacioneve ALBCORS dhe monitorimi i sistemit nëpërmjet matjeve GNSS. | 25 vjet |
| **B** | Dokumente mbi ndjekjen dhe zbatimin e kontratave referuar projekteve për realizimin e shërbimeve të "Mirëmbajtjes së stacioneve gjeodezike të rrjetit shtetëror gjeodezik aktiv ALBCORS", "Ndërtimi i pjesshëm i KRGJ", etj. Raporte periodike në lidhje me ecurinë e projekteve, etj. Raporte periodike mujore për mirëmbajtjen e ALBCORS, Ndërtimi i pjesshëm i KRGJ", etj. Programe pune, autorizime për punonjësit në lidhje me kontrollin hartografik dhe plotësimin e dataseteve me të dhëna nga terreni, për rikonicion në terren për përcaktimin e pozicionit gjeografik të reperave në funksion të realizimit të nivelimit gjeometrik. | 25 vjet |

| | | |
|---|---|---|
| **B** | Propozime për ndryshime ligjore dhe akte nënligjore brenda fushës së veprimtarisë së drejtorisë. Korrespondenca të thjeshta me institucione të ndryshme lidhur me kërkesat për informacione që ASIG disponon, etj. Memo, kërkesa, praktika, korrespondenca të thjeshta lidhur me projekte të ndryshme etj. Praktika, dokumente, memo për pjesëmarrje në aktivitete, workshop-e, trajnime, takime brenda dhe jashtë Shqipërisë, etj. | 25 vjet |
| **B** | Raporte të punës së kryer nga punonjësit, etj. Kërkesa/memo për lëvizje jashtë vendit. Kërkesa, memo, marrëveshje, procesverbale për zhvillimin e praktikave të punës, praktikave mësimore nga studentë, etj. Kërkesa, memo, vërtetime për zhvillimin e veprimtarisë së mësimdhënies nga punonjësit, etj. | 25 vjet |
| | **IV. Drejtoria e GIS-it Kombëtar dhe Gjeoportalit** | |
| **4** | **Dokumente/shkresa në veprimtarinë e Drejtorisë së GIS-it Kombëtar dhe Gjeoportalit** | |
| **A** | Urdhra, vendime, udhëzime, raporte, rregullore, programe pune, marrëveshje, dokumenta/ procesverbale mbi veprimtarinë e drejtorisë, etj. Kontrata me të huaj, etj. | RHK |
| **A** | Dokumente të ndryshme, kontrata, korrespondenca me institucione të ndryshme në lidhje me realizimin e kontratave të ndryshme, etj. Praktika e plotë e procedurës së prokurimit dhe realizimit të saj për "Prodhimi i ortofotove nga fotografitë ajrore historike" dhe produktet e përftuara + USB/CD), etj. | RHK |
| **B** | Kërkesa për informacione/ortofoto nga subjekte shtetërore, private dhe nga individë (ortofoto historike; ortofoto 2007 – 2019; ortofoto satelitore 2023-2025), materiale në CD, etj. Korrespondencë me autoritetet publike përgjegjëse për temat e gjeoinformacionit, për informacion gjeohapësinor të standardizuar dhe të përditësuar, referuar ligjit të ASIG nr. 72/2012, i përditësuar, etj. Raporte kontrolli të infrastrukturës TIK dhe backup-e të infrastrukturës software. Ofrimi i infrastrukturës mbështetëse dhe backup-e për sistemin ALBCORS, etj. Publikimi në Gjeoportalin Kombëtar i të dhënave gjeohapësinore sipas temave të dërguara nga autoritetet publike përgjegjëse, si dhe të produkteve hartografike dhe i fotografive 360 gradë, ortofoto satelitore, të përftuara nga puna në terren e strukturave të tjera në ASIG. | 25 vjet |
| **B** | Kërkesa për regjistrim/regjistrimi i përfaqësuesve nga institucione të ndryshme në Gjeoportalin Kombëtar lidhur me përdorimin e shërbimeve të Gjeoportalit. | 25 vjet |
| **B** | Kërkesa/memo për lëvizje jashtë vendit. Praktika, dokumenta, memo për pjesëmarrje në aktivitete, workshop-e, trajnime, takime brenda dhe jashtë Shqipërisë, etj. Kërkesa, memo, marrëveshje, procesverbale për zhvillimin e praktikave të punës, praktikave mësimore nga studentë. Kërkesa, memo, vërtetime për zhvillimin e veprimtarisë së mësimdhënies nga punonjësi, etj. Memo sektoriale, dokumente/ procesverbale mbi veprimtarinë e drejtorisë. Dokumenta/ praktika për pjesëmarrje në trajnime brenda dhe jashtë Shqipërisë, etj. | 25 vjet |

| | | |
|---|---|---|
| | **V. Drejtoria e Përpunimit të të Dhënave Remote Sensing** | |
| **5** | **Dokumente/ shkresa në veprimtarinë e Drejtorisë së Përpunimit të të Dhënave Remote Sensing** | |
| **A** | Urdhra, vendime, udhëzime, raporte, rregullore, programe pune, marrëveshje, dokumenta/ procesverbale mbi veprimtarinë e drejtorisë. Kontrata me të huaj, etj. | RHK |
| **A** | Dokumente të ndryshme, kontrata, korrespondenca me institucione të ndryshme në lidhje me projektin: "Shërbimi Satelitor", etj | RHK |
| **A** | Administrimi i informacionit gjeohapësinor të kapur (mbledhur) me metodat Remote Sensing ku përfshihen dhe imazhet satelitore, të teknologjisë UAV, kamera 360 gradë, etj, si dhe përgatitja e shkresave, memo-ve apo raportimeve në kuadër të projekteve të brendshme apo me bashkëpunim të huaj, etj. | RHK |
| **B** | Materiale nga grupet e punës në lidhje me përpunimin dhe analizimin e të dhënave të informacionit gjeohapësinor të kapur (mbledhur) me metodat Remote Sensing ku përfshihen dhe imazhet satelitore, të teknologjisë UAV, kamera 360 gradë, etj dhe dorëzimi me memo i raportimeve nga grupet e punës me memo mbi detyrat e kryera si dhe shpërndarja e informacionit të përpunuar gjeohapësinor për autoritetet publike sipas fushave të tyre të përgjegjësisë, etj. Programe pune, autorizime të punonjësve në terren lidhur fotografimin dhe publikimin e fotografive 360 gradë në Gjeoportalin Kombëtar, lidhur me rilevimin, fotografimi dhe mbledhjen e informacionit gjeohapësinor të kapur nëpërmjet UAV. | 25 vjet |
| **B** | Korrespondencë me autoritetet përgjegjëse për caktimin e personave përgjegjës/pikës së kontaktit të nevojshme për analizimin dhe përpunimin e thelluar të informacionit të marrë nga teknologjitë e avancuara etj.<br>Manuale të hartuara në bashkëpunim autoritetet përgjegjëse, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë, etj. Korrespondencë me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile lidhur me pranimin e konfirmimin e produkteve të ofruara nga kontraktori Satellogic.<br>Korrespondenca me institucionet vendore në lidhje me dorëzimin e produkteve të përftuara nga projekti "Shërbimi Satelitor".<br>Udhëzime për mënyrën e përdorimit të informacionit të përftuar nga monitorimi i territorit me teknologji të avancuar, etj. | 25 vjet |
| **B** | Praktika, dokumente, memo për pjesëmarrje në aktivitete, workshop-e, trajnime, takime brenda dhe jashtë Shqipërisë, etj. | 25 vjet |
| | **VI. Drejtoria e Koordinimit dhe Projekteve** | |
| **6** | **Dokumente/shkresa në veprimtarinë e Drejtorisë së Koordinimit dhe Projekteve** | |
| **A** | Urdhra, vendime, udhëzime, raporte, rregullore, programe pune, marrëveshje, dokumenta/ procesverbale mbi veprimtarinë e drejtorisë, etj. | RHK |
| **B** | Analiza risku dhe raporte mbi realizimin e projekteve dhe produktet e përftuara nga projektet në fushën e gjeoinformacionit, etj. | 25 vjet |

| | | |
|---|---|---|
| **B** | Projektakte të hartuara/përditësuara në bashkëpunim me strukturat brenda ASIG, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë që lidhen me rregullat dhe standardet e sektorit të gjeoinformacionit, etj. Mendime për projekt-ligje, projekt-vendime, projekt-akte të propozuara nga ASIG apo institucione të tjera në kuadër të dhënies së mendimit, etj. Korrespondencë me autoritetet publike përgjegjëse për temat e gjeoinformacionit për dërgimin e informacioneve gjeohapësinore të përditësuara, referuar ligjit të ASIG nr. 72/2012, i përditësuar, etj. Rekomandime të përgatitura lidhur me masat ligjore dhe organizative për ndryshimin e legjislacionit dhe përputhjen e tij me aktet komunitare., etj. | 25 vjet |
| **B** | Kërkesa për informacione gjeohapësinore/ortofoto nga subjekte shtetërore, private dhe nga individë, (p.sh: ortofoto historike; ortofoto 2007 – 2019; ortofoto satelitore 2023-2025), materiale në CD, etj. | 25 vjet |
| **B** | Korrespondenca të thjeshta mbi funksionimin e Bordit të Informacionit Gjeohapësinor - BIG, procesverbale të mbledhjes së BIG, etj, kërkesa apo propozime për BIG në bashkëpunim me strukturat brenda ASIG, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë lidhur me nismat dhe projektet e autoriteteve publike përgjegjëse, në fushën e gjeoinformacionit, etj. | 25 vjet |
| **B** | Programe pune, autorizime, informacione periodike dhe raport vjetor mbi realizimin e trajnimeve në fushën e gjeoinformacionit, me të gjithë stafet teknike të Njësive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë. Korrespondenca të thjeshta me Bashkitë e Republikës së Shqipërisë lidhur me kryerjen e trajnimeve me stafet teknike, dërgim informacioni gjeohapësinor, etj. | 25 vjet |
| **B** | Përgatitja në bashkëpunim me strukturat e tjera të ASIG dhe përcjellja e publikimeve të ASIG- "Arritjet e ASIG 2023-2024". | 25 vjet |
| | **VII. Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse** | |
| **7** | **Dokumenta për strukturën organizative dhe numrin e punonjësve** | |
| **A** | Struktura e miratuar, organika, udhëzime, ndryshime, etj. | RHK |
| **B** | Propozime për strukturën, ristrukturimin, shkresa, korrespondencë e thjeshtë, etj. | 25 vjet |
| **8** | **Dokumenta për emërime, transferime, ngritje në detyrë, masa disiplinore** | |
| **A** | Vendime dhe urdhra emërimi, etj. | RHK |
| **B** | Procedura të plota të emërimeve, kontrata pa afat, kontrata të përkohshme, masa disiplinore, njoftime, kundërshtime, vendime përfundimtare, evidenca, raporte, relacione. Korrespondencë e thjeshtë me AKPA-në, etj. | 25 vjet |
| **9** | **Dokumente për personelin** | |
| **A** | Dosjet personale të punonjësve të institucionit, etj. | RHK |
| **B** | Libreza pune. | 120 vjet pas lindjes |
| **B** | Kërkesa, vërtetime pune, vërtetime page, vërtetime për mospasjen masë disiplinore të punonjësve. Kërkesa, memo, marrëveshje për zhvillimin e praktikave të punës, praktikave mësimore apo çdo veprimtarie të jashtme nga | 25 vjet |

| | | |
|---|---|---|
| | punonjësit. Kërkesa, memo, vërtetime për zhvillimin e veprimtarisë së mësimdhënies nga punonjësit. Kërkesa, praktika mbi miratimin e lejeve vjetore të punonjësve. Praktika, dokumenta, memo për pjesëmarrje në aktivitete, workshop-e, trajnime, takime brenda dhe jashtë Shqipërisë. Kërkesa për trajnime/pjesëmarrje dhe certifikata nga ASPA, DPA për punonjësit lidhur me trajnimet e zhvilluara, etj. Regjistra personeli, etj. Dokumente mbi largimin me leje lindje dhe rikthimin nga leja e lindjes, (memo, urdhra, kërkesa, njoftime), etj. | |
| **10** | **Dokumente për konfliktin e interesit dhe zyrtarët raportues të interesave private** | |
| **A** | Urdhra, vendime, dokumente të veprimtarisë së Autoritetit Përgjegjës pranë institucionit, etj. | RHK |
| **B** | Kërkesa, memo për veprimtarinë e Autoritetit Përgjegjës pranë institucionit. Praktika, njoftime mbi rastet e konfliktit të interesit të deklaruara apo konstatuara. Informacione të Autoritetit Përgjegjës për ILDKPKI për subjektet deklarues. Njoftime/akte kontrolli të ILDKPKI pranë institucionit, korrespondencë e thjeshtë, etj. | 25 vjet |
| **11** | **Dokumente mbi zhvillimin e procedurave të prokurimit** | |
| **A** | Urdhra, vendime për ngritjen e grupeve të punës në zhvillimin e procedurave të prokurimit nga institucioni, etj. | RHK |
| **A** | Praktika të plota fituese të procedurave të prokurimit dhe realizimit të tyre (produktet e përftuara + CD), etj. | RHK |
| **B** | Praktika të plota të grupeve të punës, (ftesë për ofertë, DST, procesverbale, ankesa nga OE, vendime, njoftime, kontrata, etj), të procedurave të prokurimit të zhvilluara nga institucioni në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, etj. | 25 vjet |
| **B** | Praktika të prokurimeve të anulluara etj. | 25 vjet |
| **12** | **Dokumente për sekretari - arkivën** | |
| **A** | Urdhra për ngritjen e Komisionit të Ekspertizës. Vendime. Listat konkrete me afatet e ruajtjes së dokumenteve të ASIG. Pasqyrat emërtuese të çeljes së dosjeve. Lista veçimi, procesverbale etj, për ekspertizën e vlerës së ruajtjes së dokumenteve. Librat e protokollit/korrespondencës, etj. | RHK |
| **B** | Informacione, procesverbale për zëvendësimin e punonjësit të sekretari-arkivë/protokollit. Libër dorëzimi për dorëzimin e dokumentave nga sekretaria në sektorë. Libër dorëzimi për dërgimin e shkresave të prodhura nga ASIG drejt institucioneve të tjera, në zyrën postare, etj. | 25 vjet |
| **13** | **Dokumente për hartimin dhe zbatimin e buxhetit** | |
| **A** | Urdhra, vendime, raporte, relacione, pasqyra përmbledhëse.<br>Buxheti i miratuar. Regjistra parashikimi dhe realizimi të prokurimeve publike, etj. | RHK |

| | | |
|---|---|---|
| **B** | Praktika për ngritje grupe pune, për inventarizimin dhe vlerësimin e vlerave materiale dhe monetare në ASIG, për kalim kapital materialesh dhe pajisjesh, etj. | 25 vjet |
| **B** | Projekt-buxheti, detajimi i buxhetit, akte normative, korrespondencë e thjeshtë me Ministrinë e Financave, etj. Përgatitja dhe dorëzimi i kërkesave buxhetore afatmesme (PBA), zbatimi i buxhetit të shtetit.<br>Evidenca, raporte monitorimi për performancën financiare, etj. Memo të ndyshme sektoriale, informacione për shpërndarjen e fondeve buxhetore dhe rialokimet e tyre brenda njësisë dhe kërkesat drejtuar organeve qendrore, etj. | 25 vjet |
| **B** | Memo, njoftime, urdhra për shlyerje detyrimesh ndaj Bashkisë Tiranë, Eurogeographics etj. Raporte auditi, pyetësorë vetëvlerësimi, regjistri i riskut. Kërkesa, vërtetime për sigurimet shoqërore, paaftësinë e përkohshme në punë, leje lindje, etj. Korrespondencë me institucione të ndryshme si: Kryeministria, Ministria e Financave, Dega e Thesarit -Tiranë, etj. | 25 vjet |